

VENDIM
Nr. 142, datë 6.2.2013

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 27, DATË 19.1.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË VLERËSIMIT DHE TË DHËNIES SË
KONCESIONEVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 5 të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në shkronjën “e”, të pikës 1, të kreut V, të vendimit nr. 27, datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas fjalisë së parë të paragrafit të dytë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Për koncesionet në autostrada, për të cilat parashikohet një vlerë investimesh mbi 50 milionë euro, vlera e sigurimit të ofertave të jetë deri në 2% të vlerës së projektit ose të shërbimit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha